



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.226/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2083/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.03.2021, ka shqyrtuar ankesën A.nr.137/2019 të datës 27.02.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banim: Rr. "Hyzri Talla" nr.2, objekti 16/kati VII, Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit/Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.04.2021, mori këtë

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.137/2019 e datës 27.02.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Ref:SBNJD-59/19 i datës 07.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesit Inspektor për Silvikulturë, Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti në Agjencinë Pyjore të Kosovës, me datë 14.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, kundër Vendimit numër Ref:SBNJD-325/2018 të datës 20.12.2018 të Komisionit Disiplinorë, me të cilin ankuesit i është shqiptuar masë disiplinore: "Largim nga zyra dhe Transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme profesionale dhe ndalimi i gradimit për (4.5) vite".

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 07.02.2019 ka nxjerr Vendimin me numër Ref:SBNJD-59/19 përmes të cilit ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 14.01.2019 të parashtruar nga ankuesi.

I pakënaqur me Vendimin numër Ref:SBNJD-59/19 të datës 07.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, më datë 27.02.2019 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1020/2019 të regjistruar me numër A.nr.137/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi për shqiptimin e masës disiplinore "Largimi nga Zyra dhe Transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme profesionale dhe udalimi i gradimit për (4.5) vite" është i kundërligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.02.2019 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Këshilli, me datë 04.03.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 15.03.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2086/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën e datës 27.02.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për marrjen e vendimit meritot administroj këto prova: Ankesën me numër protokoll:1020/2019 të regjistruar me numër A.nr.137/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 14.01.2018 me nr.120; Vendimin me numër Ref:SBNJD-59/19 të datës 07.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin numër Ref:SBNJD-325/2018 të datës 20.12.2018 i Komisionit Disiplinor; Njoftimin për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 26.11.2018; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 23.11.2018; Kërkesën për përdorim të përkohshëm të veturave zyrtare te datës 19.11.2018; Kërkesën për përdorim të përkohshëm të veturave zyrtare te datës 20.11.2018; Kërkesën për përdorim të përkohshëm të veturave zyrtare te datës 21.11.2018; E-mailin e datës 22.11.2018; Ftesën për seancën e parë disiplinore e datës 05.12.2018 me numër SBNJD-302/2018; E-mailin e datës 07.12.2018 drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv; Përgjigjen në kërkesën e datës 10.12.2018; E-mailin e datës 11.12.2018 drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv; Përgjigjen në kërkesë të datës 14.12.2018; Ftesën për seancën e dytë të Komisionit Disiplinor të datës 18.12.2018; E-mailin e datës 18.12.2018; E-mailin e datës 20.12.2018 drejtuar ankuesit; E-mailin e datës 19.12.2018; E-mailin e datës 20.12.2018 drejtuar R.H; Kërkesën për pushim shëndetësor te datës 24.12.2018; Raportin mjekësor te ndërprerjes së përkohshme të punës te datës 24.12.2018; Pjesën e procesverbalit të datës 24.10.2013 me Ref: ZPD, Deklaratën e datës 17.09.2013; Njoftimin e datës 11.10.2013; Procesverbalin e datës 07.02.2019; Procesverbalin e datës 23.01.2019; Procesverbalin e datës 20.12.2018 me numër ref:SBNJD-324/2018; Procesverbalin e datës 20.12.2018 me numër ref:SBNJD-323/2018; Përshkrimin e rastit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë; Akt emërimit e ankuesit me shifër ZPD: 279/2013 te datës 31.12.2013; Njoftimin e Këshillit me numër protokoll:3615/2019 të datës 16.08.2019; Aktgjykimin me numër A.nr.2083/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative i datës 15.03.2021; Kërkesën e ankuesit për qasje në dokumente publike të datës 27.02.2019; Vendimin e Këshillit më numër Nr.12/2019 të datës 16.08.2019 për lejimin e qasjes në dokumente publike.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me numër Ref:SBNJD-59/19 i datës 07.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës është i kundërligjshëm pasi që ka lënë në fuqi Vendimin me numër Ref:SBNJD-325/2018 të datës 20.12.2018 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës i cili sipas ankuesit nuk është nxjerr konform rregullores meqenëse i njëjti ka munguar në seancën disiplinore me arsyen se ka qenë në pushim mjekësor, si dhe detyrat e dhëna nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk janë pjesë e përshkrimit të detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave, gjatë shqyrtimit të prova të lëndës, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës me Vendimin numër Ref:SBNJD-59/19 të datës 07.02.2019 ka refuzuar ankesën e ankuesit ndërsa ka lënë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor numër Ref:SBNJD-325/2018 të datës 20.12.2018 me të cilin ankuesit i është shqiptuar masë disiplinore *"Largim nga Zyra dhe Transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme profesionale"* dhe *"ndalimi i gradimit për (4.5) vite"*. Me tutje Kolegji konstaton se ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore pas inicimit të rastit nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë se i njëjti ka refuzuar urdhrin e tij, ku sipas deklaratës të datës 22.11.2018 drejtuar udhëheqësit të drejtpërdrejtë ankuesi nuk kishte pranuar të dalë në teren me kolegun e tij M.B për të përmbyllur aktivitetin e inspektimit apo detyrave të papërfunduara të datës 19.11.2018 pasi që sipas tij kolegu M.B është i papërshtatshëm për punë në teren si dhe në vitin 2012 kishin qenë së bashku në komisionin disiplinor me kolegun M.B për shkak të pakënaqësive ndaj njëri tjetrit. Andaj, bazuar në këtë, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *"Largim nga Zyra dhe Transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme profesionale dhe ndalimi i gradimit për (4.5) vite"*, ka vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren Nr.04/2011 për procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i cili përcakton se: *"Për shkelje të rënda-serioze të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, nëpunësit civil mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore: Largim nga Zyra dhe Transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në 5 vite nga komisioni disiplinor"*, pasi që ankuesi me veprimin e tij, mosrespektimin e zbatimit të urdhrin të udhëheqësit të drejtpërdrejtë ka shkelur Rregulloren Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 10 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"Nëpunësit civil duhet të zbatojnë politikën e veprimit të udhëheqësve drejtues dhe sjellja e tyre duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi"* si dhe Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, i cili përcakton se: *"Shkelje të rënda-serioze konsiderohen: Shkelja të rënda-serioze të Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civil"*, ngase ankuesi me datën 19.11.2018 sipas kërkesës për përdorim të përkohshëm të veturave zyrtare dhe deklaratës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë së bashku me kolegun pa asnjë kundërshtim kishte dalë në inspektim dhe kontroll për ndalimin e dy ngarkesave me dru në Regjionin e Ferizajt dhe Prizrenit sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe me këtë rast ankuesi nuk kishte raportuar asnjë vërejtje gjatë asaj dite ndaj kolegut z. siç kërkohet me Rregulloren Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 10 paragrafi 3 i cili përcakton se: *"Nëpunësit civil duhet t'i paraqesin problemet që shfaqen gjatë ushtrimit të detyrës dhe të diskutojnë për gjetjen e zgjidhjeve më efektive me udhëheqësit drejtues"*, andaj mbi bazën e kësaj pretendimet e ankuesit janë të papabazuara dhe të paqëndrueshme.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë sipas kërkesës me numër reference DQIPGJ 449/2018 e ka iniciuar procedurën disiplinore me datë 23.11.2018, një ditë pas deklaratës me shkrim të datës 22.11.2018 apo dy ditë pas kundërshtimit verbal të datës 21.11.2018, ndërsa po ashtu në bazë të njoftimit me numër reference SBNJD-286/18 të datës 26.11.2018 njësia e personelit ankuesin e ka njoftuar se ndaj tij është iniciuar procedura disiplinore me dyshim për shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe se rasti është proceduar në Komisionin Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe po ashtu ankuesit i është dërguar ftesa me njoftimin se seanca e par disiplinore do të mbahet më datën 07.12.2018 duke filluar në ora 09:30h në zyrat e Agjencisë Pyjore të Kosovës duke e njoftuar ankuesin se në seancë disiplinore mund të shoqërohet me një person tjetër me të cilin mund të këshillohet gjatë rrjedhës së seancës disiplinore, në kuptim të kësaj Kolegji ka konstatuar se iniciimi i procedurës disiplinore si dhe njoftimi i ankuesit nga njësia e personelit janë realizuar në pajtim me Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil nën 12 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.1 dhe 3.2, i cili përcakton se: *“Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej dy ditë pune do ta paraqesë rastin të udhëheqësi i njësisë së personelit”*; *“Udhëheqësi i njësisë së personelit, pas paraqitjes së rastit në komisionin disiplinor, e njofton shkelësin e dyshuar brenda tri (3) dite pune, për: natyrën e shkeljes së dyshuar si dhe paraqitjen e rastit për shqyrtim të komisionit disiplinor”*. Ankuesi me datë 07.12.2018 përmes emailit në ora 09:13h e ka njoftuar udhëheqësen e personelit dhe Kryeshëfin Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, shtatëmbëdhjetë (17) minuta para se të fillojë seanca se nuk mund të marr pjesë në seancën e planifikuar pas që nuk e pranon përbërjen e komisionit disiplinor *(dy anëtarët: kryetarin e komisionit dhe anëtarin z. _____)* me pretendimin se janë në konflikt administrativ me shkelësin e dyshuar respektivisht ankuesin. Ndërsa me datë 10.12.2018 Kryeshëfi Ekzekutiv i ka kthyer përgjigje ankuesit përmes shkresës me numër reference KE-768/2018 me të cilën ka hedhur poshtë pretendimet mbi kundërshtimin e anëtarëve të komisionit disiplinor duke i tërhequr vërejtjen shkelësit të dyshuar që në seancën disiplinore të radhës të marr pjesë, në të kundërtën seanca do të zhvillohet edhe pa prezencën tuaj. Me datë 18.12.2018 njësia e personelit i ka dërguar ftesën e dytë me njoftimin se seanca e radhës e Komisionit Disiplinor do të mbahet me datë 20.12.2018 duke filluar në ora 09:30h në zyrat e Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa ankuesi njoftimin se nuk do të marr pjesë në seancën e paraparë të mbahet me datë 20.12.2018 duke filluar në ora 09:30h e ka bërë me datë 19.12.2018 në ora 17:01h me pretendimet se gjendet në pushim mjekësor që nga data 18.12.2018. Udhëheqësja e Personelit me datë 20.12.2018 në ora 09:59h i ka shkruar përmes emailit ankuesit se deri në ora 12h të datës 20.12.2018 të përcjellni përmes mjeteve teknologjike apo edhe në kopje fizike dokumentin që dëshmon gjendjen tuaj shëndetësore pasi që jeni në procedurë disiplinore dhe se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës disiplinore sipas kërkesës suaj, me ç’rast kryetari i komisionit disiplinor z. _____ është zëvendësuar nga anëtarin tjetër z. _____ Ankuesi me datë 20.12.2018 në ora 12:41h i ka kthyer përgjigje Udhëheqëses së personelit përmes emailit se pushimi mjekësor është hapur nga data 18.12.2018 deri me datë 22.12.2018 me rekomandimin që me datë 24.12.2018 të paraqitet te mjeku me qëllim që të konstatoj gjendjen shëndetësore se a është e nevojshme të vazhdoj edhe me tutje apo ta mbyll pushimin mjekësor, andaj mbi bazën e kësaj Komisioni Disiplinor me rastin e vendosjes në seancën disiplinore të datës 20.12.2018 ka vepruar në pajtueshmëri Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil nën 14 paragrafi 2 dhe 3 i cili përcakton se: *“Në seancën e komisionit disiplinor duhet të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët, ndërsa vendimet merren me shumicën e anëtarëve”* dhe *“Faktet dhe dëshmitë për seanca disiplinore duhet të kompletohen sa më shpejtë që është e mundur dhe komisioni duhet marr vendimi brenda 30 ditëve prej lajuërimit të rastit”*, pasi që sipas procesverbalit me numër Ref: SBNJD-324/2018 komisioni disiplinor me rastin e vendimmarrjes ka qenë në përbërje të plotë dhe janë nënshkruar të tre (3) anëtarët e komisionit si dhe

procesmbajtësja, dhe po ashtu vendimi është nxjerrë në ditën e njëzetetë (28) nga dita e inicimit të rastit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që detyrat e dhëna nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk janë pjesë e përshkrimit të detyrave të punës, në bazë të Akt Emërimit të ZPD: 279/2013 të datës 31.12.2013 ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës në vendin e punës Inspektor për Silvikulturë, Mbrotjtje të Pyjeve dhe Gjueti dhe se në bazë të përshkrimit të detyrave të punës të specifikuar në formularin PDP, detyrat kryesore për pozitën inspektor i pylltarisë pika 1 dhe 15 e përcaktojnë: *"Kontrollon të gjitha punët dhe aktivitetet në pyje, objektet, veglat, sharrat si dhe të gjitha vendet ku druri prehet, vendoset, përpunohet, tërhiqet nga pylli ose vihet në qarkullim"* dhe *"Kryen dhe zbaton detyra tjera që lidhen me natyrën e punës që jepen nga Udhëheqësi i Drejtorit të Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë apo Udhëheqësi i Sektorit të Inspektoratit të Pylltarisë"*, në këtë kuptim pretendimi i ankuesit se detyra e dhëna nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk janë pjesë e përshkrimit të detyrave të punës janë të paqëndrueshme dhe të pabaza dhe mbi bazën e kësaj me rastin e mos zbatimit të urdhrit të drejtpërdrejt për zbatimin e detyrave që kanë qenë pjesë e përshkrimit të detyrave të tij të punës ankuesi ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të republikës së Kosovës nenin 51 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"Nëpunësit civilë i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës"* si dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nenin 5 paragrafi 2 i cili përcakton se: *"Nëpunësit civil duhet t'i kryejnë punët dhe detyrat në mënyrë të drejtë dhe efikase"*, në këtë kuptim veprimet e ankuesit janë në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të republikës së Kosovës nenin 51 paragrafi 4 i cili përcakton se: *"Nëpunësit civilë, të cilët tregojnë pakujdesi në respektimin dhe zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore"*, andaj për mos zbatim të detyrave të punës nëpunësit civil u nënshtrohen masave disiplinore siç është e përcaktuar edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të republikës së Kosovës neni 63 paragrafi 1: *"Nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref:SBNJD-59/19 të datës 07.02.2019 si dhe Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref:SBNJD-325/2018 të datës 20.12.2018 kanë vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.226/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuuesit,
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

